


	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Datë/a:	24.05.2019
Për/ Za/ To:	N.T.P. "Vlora"-Prishtine
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 22.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.T.P."VLORA" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me rekuizita sportive", me Nr. të Prok: 616-18-860-121,nxjerr:

V E N D I M

1.Refuzohet kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P."VLORA" të dt. 22.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rekuizita sportive", me Nr. të Prok: 616-18-860-121,ne Njoftimin Vendimit te Autoritetit Kontraktues te dates 17.05.2019.

1.Autoriteti Kontraktues, do te vazhdoj aktivitetin e prokurimit sipas Vendimit te dates

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 24.05.2019 ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim dhe ka konstatuar si vijon:

- Pretendimet për mos saktësi të vlerave të faturave dhe kontratave të dorëzuara janë të drejtuara në adresë të gabuar pasi që kjo është në përgjegjësi të tenderuesit dhe jo të Autoritetit Kontraktues. Autoriteti Kontraktues është bazuar në dëshmitë e paraqitura nga tenderuesi dhe ato dëshmi i plotësojnë kërkesat e FDT-se;
- Pretendimi se asnjë tenderues tjetër nuk është i përgjegjshëm është plotësisht i paqëndrueshëm, pasi që kërkesat e FDT-se janë që tenderuesi duhet të ofroj dëshmi për furnizime të ngjajshme e jo të njëjta dhe pretenduesi do të duhej të krahasoj këto pretendime me pretendimet e veta në aktivitetet e kaluara ku ka insistuar që dëshmitë e tij për furnizimet me material shpenzues të trajtohen si furnizime të njëjta-furnizime me rekuizita sportive.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në faktin se pretendimet janë të pa bazuara ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kunder këtij Vendimi mund të parashtrohet

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

